



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.139-2/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj - kryesuese, Skender Çoçaj dhe Arsim Hamzaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me kërkesën për rishqyrtim Anr.139-4/2025, të subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër vendimit të PZAP-it Anr.139/2025 të datës 24.01.2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë; 04.02.2025, merr këtë,

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar kërkesa Anr.139-4/2025 e datës; 01.02.2025, e subjektit politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar rishqyrtimin dhe anulimin e vendimit të PZAP-it, A.nr.139/2025, të datës 24.01.2025, me të cilin ankesa është hedhur e pasafatshme.

A r s y e t i m

Paneli me Vendimin Anr.139/2025 të datës 24.01.2025, ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) e ka hedhur të pasafatshme. PZAP-i, me datë; 01.02.2025, ka pranuar kërkesën për rishqyrtimin e vendimit Anr.139/2025, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, me të cilën pretendohet se mbi bazën e prezentimit të fakteve të reja nuk është administruar në mënyrë meritore dhe të duhur nga Paneli koha e dorëzimit të ankesës nëpërmes postës e dorëzuar me datën 21.01.2025.

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se, kërkesa për rishqyrtim dhe anulimin e vendimit Anr.139/2025, e datës; 24.01.2025, është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës përkatësisht kërkesa Anr.139-4/2025, e datës 01.02.2025, për rishqyrtimin e vendimeve rrjedh se subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës nuk ka arritur që të vërtetojë pretendimet e parashtruara në kërkesë, kjo për faktin se PZAP-i pas shqyrtimit të kërkesës erdhi në përfundim se nuk kemi të bëjmë me prezantimin e fakteve apo provave të reja nga se në momentin e shqyrtimit dhe vendosjes nga PZAP-i pala ankuese nuk e kishte faktuar se ankesën e kishte dorëzuar në poste me datën 21.01.2025, por se shkresën në fjale-dëshminë e dorëzimit e ka bashkangjitur me vone gjegjësisht kërkesës për rishikim.

Në rastin konkret subjekti politik Partia Demokratik e Kosovës, kërkesën për rishikim të vendimit nuk e ka mbështetur në asnjë provë apo fakt të ri, që do ta bind panelin që të njëjtën kërkesë ta aprovojë si të bazuar.

Duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e lartcekura konkludohet se vendimi i kontestuar me rishikim, rezulton të jetë i drejte, i ndërtuar mbi fakte, prova dhe i mbështetur në dispozitat ligjore në fuqi.

Ligji Nr.08/L-228, për Zgjedhjet Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përkatësisht neni 118 paragrafi 4, me të cilin përcaktohet se, *“Vendimi i PZAP-së mund të ankimohet në Gjykatën Supreme të Kosovës, sikurse që PZAP ja mund të rishikojë cilindo nga vendimet e marra, pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar. Ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda dyzet e tetë (48) orëve nga pranimi i vendimit të PZAP-së, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë se pesë mijë euro (5.000 €), ose në rast se çështja lidhet me një të drejtë themelore. Gjykata Supreme e Kosovës vendos në afatin prej pesë (5) ditësh nga paraqitja e ankesës.*

Nga shkresat e lëndës PZAP-i ka gjetur se për rastin e njëjtë dhe për të njëjtën çështje është vendosur me vendimin e PZAP-it Anr. 119/2025 të datës 24.01.2025 me të cilën subjektit politik LVV i është shqiptuar gjoba në vlerë prej 6, 000 euro, dhe vendimi i PZAP-it është vërtetuar me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës AA 13/2025 të datës 29.01.2025 me të cilën ankesën e subjektit politik LVV e ka refuzuar të pabazuar.

Prandaj PZAP-i, duke u bazuar në arsyet e lartcekura vendosi që kërkesën për rishikim të refuzojë si të pabazuar në kuptim të nenit 118 paragrafin 4 e lidhur me nenin 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.139-2/2025, datë;04.02.2025

Kryesuese e Panelit
Kymete Kicaj



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.